



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-066

Prishtinë, më 4 qershor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË TË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 4 QERSHOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Millosavleviq dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 maj 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 maj 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 28 maj 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 7 qershor 2012, me këtë

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Miratimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me rolin dhe pozitën e fëmijëve në Kosovë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër,
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Komisionit për përzgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës,
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2011,
9. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2011.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

3.1. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës për rishikimin e buxhetit, për vitin 2012

Sekretari i Kuvendit të Kosovës, Ismet Krasniqi, i informoi në hollësi anëtarët e Kryesisë lidhur me kërkesën e Kuvendit për rishikimin e buxhetit, për vitin 2012.

Për këtë çështje diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit dhe Ardian Gjini, kryetar i Grupit Parlamentar të AAK-së, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi e shqyrtoi rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për rishikimin e buxhetit, për vitin 2012, mori këtë:

V E N D I M

I. Miratohet kërkesa e Kuvendit të Kosovës për mjete shtesë lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2012, në vlerë prej 226,600 €, si në vijim:

1. Programi- Deputetët e Kuvendit

- Mallra dhe shërbime, në vlerë prej 36,000 €

2. Programi – Administrata e Kuvendit

- Paga dhe mëditje, në vlerë prej 106,600 €.
- Investime kapitale, në vlerë prej 84,000 €, për projektet si në vijim:
 - Rinovimi i aneksit, në vlerë prej 50,000 €,
 - Modernizimi dhe paisja me teknologji digjitale të sallave të konferencave dhe sallës plenare, në vlerë prej 30,000 €,
 - Automjete për nevoja të Kuvendit, në vlerë prej 4,000 €.

II. Miratohet kërkesa e Kuvendit të Kosovës për transferet e brendshme buxhetore në rishikim të buxhetit për vitin 2012, në vlerë prej 43,000 €, si në vijim:

1. Programi – Administrata e Kuvendit

- Transferi nga kategoria ekonomike- shpenzime komunale në kategorinë ekonomike- Mallra dhe shërbime, në vlerë prej 40,000€,
- Transferi brenda kategorisë ekonomike- Projektet kapitale, nga projekti kapital -Shkallët kundër zjarrit, shuma prej 3,000€, transferohet në projektin kapital -Ndërrimi i ashensorit hidraulik në atë elektrik- të hyrja kryesore.

III. Komisioni nuk përkrahu kërkesat shtesë të Kuvendit të Kosovës, për rishikimin e buxhetit për vitin 2012, në vlerë prej 49,020 €, në emër të stafit mbështetës politik të zyrave rajonale.

3.2. Njoftimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Slloveni, prej 7-11 maj 2012

Kryesia u njoftua me vizitën e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, të realizuar në Slloveni, prej 7-11 maj 2012.

3.3. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë dhe për caktimin e delegacionit pjesëmarrës nga Kuvendi i Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, lejoi udhëtimin zyrtar të delegacionit nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i Kuvendit të Republikës së Kosovës, që do të marrin pjesë në seminarin me temën “ Modernizimi i bujqësisë dhe implementimi i politikave të përgjithshme bujqësore”, në Belgjikë, prej 27-30 qershor 2012.

Pikë shtesë

1. Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë, në Asamblenë Parlamentare të NATOS-s

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e cekur më lartë, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i deputetëve të Kuvendit të Kosovës, në këtë përbërje: Zenun Pajaziti, Hykmete Bajrami dhe Jelena Bontiq, që të marrin pjesë në “Programin për parlamentarë të rinj”, në Asamblenë Parlamentare të NATOS-s, prej 10-14 qershor 2012.

2. Shpenzimet e akomodimit për tre deputetët mbulohen nga organizatori, ndërsa nga buxheti i Kuvendit të Kosovës, mbulohen shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet shtesë.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:35** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale